

**VENDIM**  
**Nr. 207, datë 6.4.2022**

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS SË SHËRBIMEVE  
POSTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, 2021 E NË VIJIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dokumentit të politikës së shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, 2021 e në vijim, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 625, datë 24.7.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**DOKUMENTI I POLITIKËS SË SHËRBIMEVE POSTARE NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË  
2021+**

**HYRJE**

Sektori postar është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare, që realizon ofrimin e shërbimeve publike postare. Shërbimet postare janë shërbime publike të interesit të përgjithshëm. Zhvillimet teknologjike, përdorimi gjithnjë e në rritje i teknologjisë së informacionit dhe i komunikimit po e përballin sektorin postar me sfida dhe me nevojën e përshtatjes në epokën e digjitalizimit, e cila i ofron njëkohësisht mundësi të reja zhvillimi, sikurse është rritja e tregtisë elektronike apo diversifikimi i shërbimeve.

Sektori postar në Shqipëri, ka kaluar në një proces ndryshimesh graduale të shtrira në kohë, nga ofrimi i shërbimit postar në kushtet monopolistike, drejt një tregu të hapur për konkurrencë graduale mbështetur në modelin e Bashkimit Evropian dhe praktikën ndërkombëtare.

Dokumenti i politikave, i miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 24.7.2013, “Për miratimin e dokumentit të zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë”, përcaktoi si objektiv të rëndësishëm hapjen e plotë të tregut postar për konkurrencë, duke reduktuar dhe më pas hequr zonën e rezervuar për ofrimin e shërbimit universal postar.

Miratimi i dokumentit të politikës për sektorin postar në vitin 2013, u shoqërua me hartimin dhe miratimin e një kuadri të ri ligjor e rregullator në periudhën 2015–2018. Ligji nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, i cili është në përputhje të plotë me direktivat e BE-së për shërbimin postar, shënoi një hap të rëndësishëm në rrugën drejt liberalizimit të sektorit postar, duke krijuar hapësirën ligjore për ofrimin e shërbimit universal nga më shumë se një operator.

Ky dokument prezanton politikën e zhvillimit të sektorit postar në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2022–2027. Qëllimi i këtij dokumenti të ri të politikës për zhvillimin e sektorit postar, është përcaktimi i objektivave për përshtatjen me zhvillimet më të fundit të sektorit postar në Bashkimin Evropian dhe atë global, përmirësimin e performancës së sektorit, si dhe adaptimin e zhvillimeve të reja, në kuadër të tregtisë elektronike (*e-Commerce*).

Dokumenti bazohet në eksperiencën e Bashkimit Evropian dhe në “Strategjinë globale të zhvillimit të shërbimeve postare”, të miratuar nga Bashkimi i Përbotshëm Postar (UPU). Dokumenti përcakton objektivat afatmesëm dhe afatgjatë për zhvillimin e sektorit postar në Shqipëri, në periudhën 2022–2027.

Në dokument paraqitet progresi i bërë në sektorin postar, situata aktuale dhe sfidat që shfaqen për zhvillimin e tregut postar. Dokumenti prezanton politikën, aktivitetet që do të ndërmerren, me qëllim implementimin e plotë të ligjit për shërbimet postare, përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ofrimit të shërbimeve postare, përmirësimin e infrastrukturës postare, sigurimin e shërbimit universal në kushtet e konkurrencës, si dhe identifikimin e rrugëve, mjeteve për përshtatjen e këtij sektori në rrethanat e zhvillimit të ekonomisë digjitale, me qëllim nxitjen e zhvillimit të tregtisë elektronike. Pjesë e objektivave të këtij dokumenti janë dhe angazhimet në nivel ndërkombëtar, në përputhje me “Strategjinë globale për zhvillimin postar”, të miratuar nga Bashkimi i Përbotshëm Postar, UPU.

Ky dokument do të zëvendësojë dokumentin e politikës të miratuar në vitin 2013 dhe synon të reflektojë zhvillimet e ndodhura në treg, si ato teknologjike, ashtu edhe zhvillimet globale, duke i përshtatur me tregun shqiptar.

## **I. Analizë e situatës aktuale**

### **I.1 Të përgjithshme – kuadri ligjor e institucional në sektorin postar**

Ofrimi i shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë rregullohet me ligjin nr. 46/2015, datë 7.05.2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”. Dokumenti i politikave për zhvillimin e sektorit postar i miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 24.7.2013, përcaktoi si objektiva afatmesëm dhe afatgjatë:

- liberalizimin e plotë të tregut;
- heqjen e zonës së rezervuar;
- përmirësimin e kuadrit ligjor me miratimin e ligjit të ri për shërbimet postare;
- krijimin e një kuadri rregullator efektiv dhe përcaktimin e rolit të AKEP-it;
- garantimin e ofrimit të shërbimit universal postar;
- zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit postar, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të reja;
- bashkëpunimin ndërkombëtar;
- zhvillimin e burimeve njerëzore etj.

Hapja e plotë e tregut postar për konkurrencë dhe harmonizimi i legjislacionit me kuadrin ligjor të BE-së, ishin dy objektiva të rëndësishëm të dokumentit të politikës për zhvillimin e sektorit postar të miratuar në vitin 2013. Nga miratimi i dokumentit të politikave postare në vitin 2013, në tregun postar kanë ndodhur një sërë zhvillimesh të rëndësishme, në lidhje me miratimin e një kuadri ligjor e rregullator bashkëkohor për sektorin postar, si dhe në drejtim të zhvillimeve për ofrimin e shërbimeve postare, në veçanti për ofrimin e shërbimit universal postar.

Kuadri ligjor për shërbimet postare është plotësisht i përafuar me direktivën 97/67/KE, të ndryshuar nga direktiva 2002/39/KE dhe direktiva 2008/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 20 shkurt 2008, dhe përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve postare në një treg të hapur, synon garantimin e ofrimit të shërbimit universal postar nga më shumë se një ofrues, si dhe përcaktimin e skemës së financimit të kostove neto të shërbimit universal postar. Ligji përcakton parimet për vendosjen e tarifave, kërkesat për transparencën e llogarive në ofrimin e shërbimeve universale, standardet për cilësinë në ofrimin e shërbimeve universale, si dhe garanton funksionimin e autoritetit të pavarur kombëtar rregullator.

Përafrimi i legjislacionit me atë të BE-së, kishte si synim hapjen graduale dhe të kontrolluar, deri në një liberalizim të plotë të tregut postar për një konkurrencë të lirë, eliminimin e zonës së rezervuar, përcaktimin e standardeve të cilësisë për ofrimin e shërbimeve universale, si dhe funksionimin e autoritetit të pavarur kombëtar rregullator. Këto procese janë realizuar me miratimin e ligjit të ri në vitin 2015, si dhe me plotësimin e kuadrit nënligjor e rregullator në periudhën 2015–2018.

Pas miratimit të ligjit nr. 46/2015, skema e re për licencimin e operatorëve, përfshin autorizimin individual për ofrimin e shërbimeve universale postare kundrejt një procesi konkurrimi, si dhe autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare jashtë zonës së shërbimit universal. Zona e rezervuar për ofrimin e shërbimit universal u reduktua në 50 gram në vitin 2013 dhe është hequr që nga 1 janari 2017 pas një periudhe tranzitore, duke i lënë në fuqi të drejtën e ofruesit të shërbimit universal Postës Shqiptare sh.a. si ofrues i parë për shërbimet postare në institucionet publike. Në aneksin 1, bashkëlidhur këtij dokumenti jepet një listë e akteve nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 46/2015, datë 7.5.2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Në kuadrin institucional në fushën e sektorit postar, detyrat e politikëbërësit dhe rregullatorit janë të ndara midis ministrisë përgjegjëse dhe rregullatorit. Sipas përcaktimeve të nenit 5 të ligjit nr. 46/2015, organet kompetente në fushën e shërbimeve postare janë ministri përgjegjës për shërbimet postare, aktualisht ministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, si politikëbërës dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si organi rregullator i pavarur.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ushtron aktivitetin, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”.

## I.2 Zhvillimet kryesore në tregun postar

Në këtë seksion prezantohen zhvillimet kryesore në tregun postar, duke u fokusuar në:

- Tregun e postës së letrave dhe të pakove në termat e volumeve dhe të ardhurave, pjesët e tregut dhe evoluimi i segmenteve të përdoruesit;
- Shërbimin universal postar dhe ofrimin e tij;
- Cilësinë e shërbimit dhe çmimet për produktet postare;
- Përgjigjen e operatorëve ndaj digjitalizimit në termat e kanaleve/mënyrave alternative të shpërndarjes dhe modeleve operacionale;
- Strategjitë e diversifikimit;
- Teknologjitë e reja të aplikuara në tregun e postës së letrave dhe pakove;

### I.2.1 Shërbimet postare dhe shërbimi universal postar

Shërbimet postare përfshijnë një numër të madh shërbimesh, si posta e letrave, posta e pakove, posta direkte, posta ekspres brenda vendit, posta jashtë vendit, postë me shumicë etj. Shërbimet postare klasifikohen në shërbime universale postare, të njohura dhe si shërbime bazë postare dhe në shërbime që bien jashtë përcaktimit të shërbimit universal postar. Figura e mëposhtme jep në mënyrë të përmbledhur gamën e shërbimeve postare, sipas klasifikimit të *Copenhagen Economics* (Zhvillimet kryesore në sektorin postar, qershor 2018).

Figura 1. Shërbimet postare B

Shërbimi universal postar përfshin shërbimet m

a) pranimin, përpunimin, transportin dhe shpë

në 2 kg;

b) pranimin, përpunimin, transportin dhe shpë

10 kg,

c) shërbimet për objektet postare të regjistruara

Në shërbimin universal përfshihet, gjithashtu


shpërndarja e objekteve postare të pranuar nga

kg. Detyrimi ligjor për ofrimin e shërbimit univers

pune në javë, përveç rrethanave ose kushteve gjeo

Zhvillimet në tregun postar, kanë hapur diskut

universal postar në nivel evropian e më gjerë.



### I.2.2 Ofrimi i shërbimeve postare në Shqipëri

Në sektorin e shërbimeve postare në Shqipëri, ushtron aktivitet Posta Shqiptare sh.a., e pajisur me autorizim individual nga AKEP-i, për ofrimin e shërbimit universal postar dhe 33<sup>1</sup> operatorë/ofrues të tjerë të shërbimeve postare, që janë aktualisht të autorizuar nga AKEP-i, për ofrimin e shërbimeve postare jashtë përcaktimit të shërbimit universal, si për shërbim postar ekspres brenda dhe jashtë vendit, për postë direkte, postë hibride, postë më shumicë etj.

Në tregun postar shqiptar, prej më shumë se dhjetë vjetësh, janë prezent dhe operojnë filiale të kompanive të mëdha postare ndërkombëtare, si DHL, TNT, FEDEX etj., me një kontribut të rëndësishëm në këtë treg, kryesisht në postën ekspres.

Posta Shqiptare sh.a., që është operator me pronësi publike, është ofruesi i vetëm i shërbimit universal postar dhe kontribuesi kryesor në ofrimin e shërbimeve postare në vend, referuar të dhënave për volumet e dërgesave postare, si dhe të ardhurave të tregut.

Në zbatim të ligjit nr. 46/2015, neni 64, pika 3, me vendimin nr. 13, datë 30.6.2020, Posta Shqiptare sh.a. është pajisur nga AKEP-i me Autorizimin Individual, si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar në të gjithë territorin e vendit, si dhe me autorizim të përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare, që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar.

### I.2.3 Zhvillimet kryesore në tregun postar shqiptar

Tregu postar shqiptar karakterizohet nga një situatë e qëndrueshme, për sa i takon volumin total të objekteve postare, në ndryshim kjo nga tendencat globale të tregut postar, ku volumi i objekteve postare, në veçanti për objektet postare letër ka shënuar rënie.

Megjithatë, numri mesatar i objekteve postare për individ në Shqipëri është shumë më i ulët krahasuar me vendet e tjera evropiane. Në Shqipëri, mesatarisht një individ dërgon 10 objekte postare në vit, ndërkohë që ky tregues në vendet e Evropës Lindore është 34 dhe në ato Perëndimore 191, siç jepet në figurën më poshtë.




Figura 2. Numri mesatar i objekteve postare për individ. Burimi: Sipas raportit të ERGP-së dhe AKEP-it

Duhet thënë që situata për sasinë e objekteve postare për çdo banor është mjaft e ndryshme dhe në vendet evropiane, duke lëvizur nga 425 letra për banor në rastin e Zvicrës, në 3 dhe 10 letra për banor në Bullgari dhe Rumani. Në rastin e Greqisë kemi 25 letra/banorë; në Itali 35, në Letoni 15, në Lituanë 22, në Rumani 10 dhe në Bullgari 3 letra/banorë. Diferencat e mëdha shpjegohen ose lidhen me disa faktorë, si: zhvillimet ekonomike e sociale, shpërndarjen demografike, zhvillimet digjitale etj.

<sup>1</sup> Deri më 31 dhjetor 2021.

Të ardhurat totale të tregut postar shqiptar, për vitin 2020, llogariten në 2,8 miliardë lekë. Ecuria në vite e këtij tregu tregon për një luhatje në të ardhurat e tregut. Pjesa kryesore e këtyre të ardhurave përbëhen nga të ardhurat e Posta Shqiptare sh.a. në nivelin 65%. Krahasuar me vitin 2014 pjesa e tregut e Posta Shqiptare sh.a., në totalin e të ardhurave të këtij tregu, ka pasur një rënie me 3% (në vitin 2014 Posta Shqiptare sh.a. zotëronte 68% të totalit).

Në tregun postar, vërehet se ka një rritje të numrit të ofruesve të shërbimit postar të autorizuar nga AKEP-i në vitet e fundit. Kështu në fund të vitit 2021 ishin 33 ofrues të shërbimit postar të autorizuar nga AKEP-i, kundrejt 12 ofruesve që ishin në vitin 2013.

Në periudhën 2014–2020, volumi i objekteve postare të përpunuara nga të gjithë operatorët postarë ka rritje konstante, përveç periudhës së pandemisë gjatë vitit 2020. Nga viti 2014 deri në vitin 2019, volumi i objekteve postare është rritur me 17%. Në vitin 2021 volumi i objekteve postare është rritur me 9.4% kundrejt vitit 2020. Posta Shqiptare sh.a., në përgjithësi, ka përpunuar në total rreth 81% të objekteve postare.

Fakti që Posta Shqiptare sh.a. mban peshën kryesore të volumit në shërbimet postare, tregon që ka një përqendrim të lartë të tregut postar dhe ndikim të ulët të hapjes së tregut postar pas liberalizimit të plotë të tij me miratimin e ligjit të ri në vitin 2015.

Pozita e Postës Shqiptare sh.a. në treg lidhet me disa faktorë, si: shtrirja gjeografike e rrjetit postar në të gjithë vendin, infrastruktura më e madhe në zotërim, ofrimi i një game të gjerë shërbimesh në zyrat postare nën konceptin e zyrës me një ndalesë dhe jo vetëm për shërbimet postare, por dhe ato financiare etj.




Figura 3. Objekte postare në total të pranuar gjatë vitit 2020. Burimi: AKEP

Gjatë vitit 2021, nga Posta Shqiptare sh.a. dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, janë pranuar në total 27,132,919 objekte postare. Pjesa më e madhe e objekteve postare janë pranuar nga Posta Shqiptare, me 21,875,416 objekte, rreth 81% të totalit.


Të dhënat statistikore tregojnë se në krahasim me vitin 2018, ka pasur një rritje prej 17% të numrit të përgjithshëm të objekteve postare të pranuar, e lidhur kjo dhe me një tendencë në rritje të tregtisë elektronike, ndërkohë që në vitin 2020, ka pasur një rënie prej 4.2% të numrit të përgjithshëm të objekteve postare të pranuar, si rezultat i situatës së pandemisë globale COVID-19, me masat e ndërmarra dhe kufizimet e transportit ajror.

Gjatë vitit 2021, nga Posta Shqiptare sh.a. dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë pranuar 27,132,919 objekte postare, duke pësuar një rritje prej 9.4% krahasuar me vitin 2020, gjatë të cilit janë pranuar 24,795,179 objekte postare. Gjatë vitit 2020, pati një ulje të numrit të objekteve postare të pranuar në periudhën janar–shtator 2020, gjë që përkon me situatën e mbylljes totale, për shkak të pandemisë COVID-19.

Në grafikët e mëposhtëm jepen të dhënat e kategorive kryesore të objekteve postare të pranuar nga Posta Shqiptare sh.a. gjatë vitit 2020 dhe gjatë 9-mujorit të vitit 2021.

### Objekte postare të pranuar nga Posta Shqiptare sh.a.

Gjatë vitit 2020



Gjatë nëntëmuorit 2021




Figura 4. Objekte postare të pranuar nga Posta Shqiptare sh.a. gjatë vitit 2020 dhe 2021. Burimi: AKEP  
Për sa u përket objekteve postare të pranuar nga Posta Shqiptare sh.a., gjatë vitit 2021, në krahasim me vitin 2020, vërehet një rritje në : +13.5% për shërbimin universal, +37.9% për shërbimin ekspres dhe një rënie për shërbimin jouniversal me 65.3%.

### Zhvillimet në infrastrukturën e rrjetit postar

Infrastruktura e rrjetit postar, përfshin një numër elementesh për shpërndarjen e objekteve postare, si: zyrat postare, kutitë postare, mjetet e transportit ajror, detar, tokësor, zyrat e përpunimit dhe tranzitit etj.

Gjatë periudhës 2014–2020, infrastruktura postare ka pasur zhvillime, në veçanti në drejtim të numrit total të zyrave postare. Numri total i zyrave postare në vend, në fund të vitit 2021 ishte 915 të tilla, shifër kjo që përgjatë viteve ka pësuar luhatje. Pjesa më e madhe e zyrave postare i përket Postës Shqiptare sh.a. Ndërkohë, nuk ka ndryshime esenciale për sa u takon qendrave të tranzitit, të përpunimit të objekteve postare.

Ecuria në total e tregut postar, për sa i përket numrit të zyrave, jepet në grafikun më poshtë:




Figura 5. Numri i zyrave postare në Shqipëri gjatë 2014–2020. Burimi: Raporte të AKEP.

Posta Shqiptare sh.a. ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal 704 sportele, ndërkohë që për pranimin e objekteve postare, ka vënë në dispozicion 579 kuti postare dhe për dorëzimin 667 kuti postare, në total 1,246 kuti postare.

Një numër të madh zyrash postare rezulton të kenë *Albanian Courier, Albanian Cargo Service, United Transport, Albanian Delivery Express, DHL International Albania* etj. Në përgjithësi, prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Postës Shqiptare, është në qytetet kryesore të vendit.

Për sa i përket infrastrukturës dhe mjeteve postare, gjatë vitit 2021, Posta Shqiptare ka në përdorim 474 mjete transporti, pasuar nga *Albanian Delivery Express* me 118, FEDEX me 113, *United Transport* me 111, të pasuar nga ofruesit e tjerë. Në mjetet e transportit përfshihen kamionë, furgonë, vetura, motorë, motoçikleta dhe biçikleta. Për sa i takon transportit ajror operohet me kompanitë ajrore, për të mundësuar dërgesat dhe pranimet e postës ndërkombëtare.

Ndërthurja e shërbimeve tradicionale postare, me shërbimet elektronike, ka nxjerrë si domosdoshmëri modernizimin dhe digjitalizimin e infrastrukturës dhe të logjistikës, të cilat ndihmojnë në ofrimin me cilësi të shërbimeve.

Megjithatë, infrastruktura postare vuan ende nga mungesa e një sistemi të saktë të adresave në shkallë vendi, veçanërisht në qytetet e mëdha. Gjithashtu, sistemi i infrastrukturës mbajtëse të pakove, të tilla si kutitë ruajtëse të pakove, nuk është i zhvilluar. Ky sistem do të mundësonte një shërbim më të mirë pranë qytetarëve.

Kodi postar i miratuar me VKM-në nr. 676, datë 4.10.2006, “Për kodin postar në Republikën e Shqipërisë”, nuk aplikohet gjerësisht në shërbimin postar dhe për më tepër, nuk është i unifikuar për të gjithë ofruesit e shërbimit postar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 20.1.2001, “Për vendosjen e kutive postare në ndërtesat e banimit dhe institucione”, përcakton vendosjen e kutive postare në të gjitha projektet për ndërtesat e reja, objekte banimi, institucione social-kulturore dhe ente prodhuese. Kutitë postare dhe lloji i tyre, kërkohet të vendosen nga vetë investitorët, në varësi të funksionit të ndërtesës. Megjithatë aplikimi i këtij rregullimi nuk është i unifikuar dhe jo në të gjitha rastet realizohet.

Në sektorin postar, në fund të vitit 2021, kishte 3,257 punonjës, ku Posta Shqiptare sh.a., si operatori me shtrirjen më të madhe, ka 2,512 të punësuar, shifër që përbën 77% të numrit total të punonjësve në këtë sektor. Nga operatorët e tjerë, numrin më të madh të të punësuarve për vitin 2021, e kishte TNT-ja, me 113 punonjës, *Albanian Delivery*, me 108 punonjës dhe *United Transport*, me 100 punonjës.

### **I.3 Ofrimi i shërbimeve nga Posta Shqiptare sh.a.**

Posta Shqiptare ka detyrimin për përmbushjen e shërbimeve bazë postare, ajo ka rrjetin e saj kombëtar me 561 zyra postare<sup>2</sup>, të shtrira në të gjithë territorin e vendit, deri në zonat më të thella rurale, si dhe ofron një numër të madh shërbimesh postare e financiare me cilësi e çmime konkurruese për individët, bizneset, institucionet, si dhe për ata që nuk kanë akses në sistemin bankar.

Shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. përfshijnë: shërbimet bazë apo universale postare, posta e letrave, e pakove, shërbimi i postës ekspres (EMS), shërbimet financiare, filatelinë, shitjet, si dhe shërbime të tjera të ofruara në çdo zyrë postare.

Si ofruese e shërbimit universal postar, Posta Shqiptare sh.a. ka detyrimin të sigurojë një minimum shërbimesh me një cilësi të specifikuar, në të gjithë territorin e vendit, me çmime të njëjta, të cilat mund të përballohen, në përfitim të të gjithë përdoruesve, pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike. Zhvillimet e fundit teknologjike kanë pasur një ndikim pozitiv dhe në cilësinë e shërbimit të ofruesit të shërbimit universal. Shërbimet postare kryhen në mënyrë të informatizuar në rreth 400 zyra postare në zona urbane dhe rurale, duke përfshirë të gjithë zinxhirin operacional postar: nga pranimi deri në dorëzimin e objektit postar, pjesë e të cilit është dhe përlllogaritja automatike e tarifave të shërbimit.

Zhvillimi i mëtejshëm i sektorit reflektohet dhe në rritjen e volumit të shërbimeve postare. Gjatë vitit 2019, numri i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare ishte mbi 26 milionë, duke pësuar një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet e mëparshme. Ndërkohë, gjatë vitit

---

<sup>2</sup> Burimi: AKEP.

2020, numri i objekteve të pranuar pësoi rënie, duke kapur shifrën e mbi 19 milionë, si rrjedhojë e situatës së krijuar nga pandemia globale COVID-19.

Ndër treguesit kryesorë të shërbimeve postare, në raport me popullsinë (banorë rezidentë 2,845,955) dhe sipërfaqen (28,748 km<sup>2</sup>) e Republikës së Shqipërisë për vitin 2020 rezulton të jenë:

- 8.71 objekte postare/banorë;
- 3,103 banorë/zyrë postare;
- 31.35 km<sup>2</sup>/zyrë.

Zhvillimi dhe përmirësimi i shërbimeve të ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. është ndikuar në një masë të madhe edhe nga informatizimi i shërbimeve postare. Përdorimi i TIK-ut në shërbimet postare, ndër vite, është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme, duke sjellë rritje të performancës dhe të cilësisë, rritje të shumëllojshmërisë së shërbimeve tradicionale dhe të atyre financiare, shtrirjen e tyre në të gjithë territorin e vendit, si dhe integrimin me shërbimet e rrjetit ndërkombëtar.

Megjithatë jo të gjitha zyrat postare janë të informatizuara, në veçanti zyrat në zonat e thella dhe të largëta.

## **II. Statusi i Shërbimit Universal Postar**

Sigurimi i shërbimit universal postar është një ndër objektivat kryesorë të ligjit nr. 46/2015, “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”. Në bazë të nenit 13, të ligjit nr. 46/2015, AKEP është autoriteti përgjegjës për licencimin/autorizimin e ofruesit/esve të shërbimit universal. Përcaktimi i ofruesit/esve, bëhet me vendim të AKEP-it, bazuar në parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit dhe sipas rregullave të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave.

Me urdhrin nr. 469, datë 27.12.2019, ministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, në mbështetje të pikës 7, të nenit 6, dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 46/2015, është përcaktuar dëndësia e pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar, duke marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve për një prezencë sa më të gjerë, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Numri i pikave të aksesit duhet të jetë i tillë që të sigurojë, që:

a) një zyrë postare t’u ofrojë shërbimin universal postar një numri mesatar të popullsisë prej 5,500 banorë;

b) të ketë një zyrë postare, mesatarisht në një sipërfaqe prej 53 km<sup>2</sup>.

Gjithashtu, urdhri përcakton se:

- në zonat urbane, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit, duhet të jetë mesatarisht 5 km;

- në zonat rurale, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit duhet të jetë mesatarisht 8 km, për të paktën 95% të popullsisë.

Bazuar në kërkesat ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar, Posta Shqiptare sh.a. duhet të zbatojë:

1. Detyrimin e ofrimit të shërbimit universal postar çdo përdoruesi në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, duke përfshirë shërbimet postare brenda vendit dhe ndërkombëtare;

2. Organizimin e rrjetit postar, me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar, sipas kërkesave të ligjit nr. 46/2015 dhe të akteve rregullatore të miratuara nga AKEP-i;

3. Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar;

4. Parimet e përcaktimit të tarifave dhe kostove për ofrimin e shërbimit universal postar.

Në zbatim të nenit 64, pika 3, të ligjit nr. 46/2015, me vendimin nr. 13, datë 30.6.2020, Posta Shqiptare sh.a. është pajisur nga AKEP-i me autorizimin individual, të vlefshëm për një periudhë 5-vjeçare, si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shërbimi universal duhet të garantohet për jo më pak se 5 ditë pune në javë, përveç rrethanave ose kushteve gjeografike që konsiderohen të jashtëzakonshme. Shërbimi universal përfshin shërbimet minimale, si më poshtë:



a) pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e objekteve postare që peshojnë deri në 2 kg;

b) pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e pakove postare që peshojnë deri në 10 kg,

c) shërbimet për objektet postare të regjistruara dhe objektet postare të siguruara.

Pavarësisht nga kufiri i peshës për pakot postare, i përcaktuar si më sipër, në ligj përcaktohet që ofruesi/t e shërbimit universal postar, duhet të sigurojnë që objektet postare, të pranuar në një vend anëtar të BE-së dhe që peshojnë deri në 20 kg, të shpërndahen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Posta Shqiptare sh.a., i siguron këto shërbime me çmime të njëjta të përballeshme, për përfitimin e të gjithë përdoruesve, pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike. Për përmbushjen e këtij detyrimi, Posta Shqiptare sh.a. operon me rrjetin e saj kombëtar, prej 561 zyrave postare, të shtrirë në të gjithë territorin e vendit deri në zonat më të thella rurale.

Ndër vite, volumi në shërbimin universal postar brenda vendit, i objekteve të pranuar, mbetet në tërësi i qëndrueshëm, megjithëse ka pasur luhajtje, por nga viti 2015 deri në fund të vitit 2019, është rritur me 16,6%. Gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin 2019 numri i objekteve kishte rënie me 14,1% për shkak të pandemisë Ndërkohë, volumi në shërbimin universal postar ndërkombëtar, ka pasur rënie në periudhën 2015–2020, siç jepet në grafikun më poshtë.




Figura 6: Ecuria e volumit të shërbimit universal gjatë 2015–2020 Burimi: Raporte të AKEP-it

Në total volumi i objekteve postare të shërbimit universal postar, ofruar nga Posta Shqiptare sh.a. brenda dhe jashtë vendit, është rritur nga 18.5 milionë objekte në 2015-ën, në 21.5 milionë objekte në vitin 2019, për të pësuar rënie gjatë vitit 2020 me 18.4 milionë objekte. Rënia e volumit në vitin 2020 lidhet me pandeminë COVID-19, që pati shumë ndikim në sektorin postar. Në total volumi i objekteve postare të shërbimit universal postar ofruar nga Posta Shqiptare sh.a. brenda dhe jashtë vendit është rritur me 11%, nga 19.7 milionë objekte në 2020-ën, në 21.8 milionë objekte në 2021-shin.

## II. 1 Standardet e cilësisë së ofrimit të shërbimit universal

Në zbatim të kërkesave të ligjit 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të rregullores nr. 36, datë 29.10.2015, “Për ofrimin e Shërbimit Universal Postar”, nga raportimet e Postës Shqiptare sh.a. për treguesit e cilësisë, për vitin 2018, rezultojnë se:

- përmasat minimale dhe maksimale për objektet postare (letra dhe pako postare), janë në përputhje me aktet e miratuara nga UPU-si, si për postën ndërkombëtare dhe për postën brenda vendit;

- është plotësuar detyrimi për publikim të informacionit për cilësinë e shërbimit universal postar;

- janë kryer testet për kohën e shpërndarjes së objekteve postare, sistemin e informimit për ndjekjen e objekteve postare, rregullsinë dhe besueshmërinë e shërbimeve kombëtare dhe ato ndërkufitare/ndërkombëtare.

Standardet e kohës së shpërndarjes për postën ndërkombëtare, ndërmjet Postës Shqiptare dhe shteteve të BE-së dhe shteteve që nuk janë anëtare të BE, realizohet nëpërmjet testeve të zhvilluara nga kompanitë postare nën monitorimin e UPU-sit, si dhe standardeve të post Evropës. Rezultatet e këtyre testeve shërbejnë si referencë për matjen e standardeve për kohën e shpërndarjes së postës ndërkombëtare.

Respektimi i standardeve në ofrimin e shërbimit universal postar, mbikëqyren nga AKEP-i. Rezultatet e testeve të realizuara në Posta Shqiptare sh.a., të paraqitura në tabelën e mëposhtme, tregojnë sa ka një përmirësim në kohën e shpërndarjes së letrës së thjeshtë ndërmjet qyteteve për D+1, ndërkohë që ka mbetur në nivel konstant koha e shpërndarjes së letrës rekomande midis qyteteve për D+1 dhe D+2

	Standardi	Realizimi 2015	Realizimi 2016	Realizimi 2017	Realizimi 2018
<b>Midis qyteteve: Letër e thjeshtë</b>					
D+1	85%	97.40%	98.09%	97.03%	99.73%
D+2	15%	2.56%	1.86%	1.60%	0.24%
Mbi D+2		0.04%	0.05%	1.10%	0.03%
<b>Midis qyteteve: Letër rekomande</b>					
D+1	85%	98.5%	98.7%	98.90%	98.20%
D+2	15%	1.4%	1.3%	1.10%	1.70%
Mbi D+2				0.00%	0.10%
<b>Midis fshatrave: Letër e thjeshtë</b>					
D+2	60%			89.80%	89.90%
D+3	20%			8.10%	8.30%
D+4	20%			2.10%	1.80%
<b>Midis fshatrave Letër rekomande</b>					
D+2	60%			91.40%	90.00%
D+3	20%			7.40%	7.90%
D+4	20%			1.20%	2.10%

*Tabela 1: Rezultatet e realizimit të standardeve në ofrimin e shërbimit universal gjatë 2015–2019. Burimi: Raporte të AKEP-it*


Në vitin 2021 treguesit kanë pasur përmirësime, dhe proporcioni i objekteve të shpërndara në D+1 (1 ditë pas pranimit) ka shënuar rritje me 2 pikë përqindjeje në krahasim me vitin 2020. Posta Shqiptare realizon në D+1 dorëzimin e 97% të objekteve postare brenda qytetit dhe 96% të objekteve midis qyteteve. Në vitin 2021 ka vijuar përmirësimi i shpërndarjes së objekteve postare në fshatra, duke arritur në shpërndarje në D+2 të 84%, krahasuar me 80% në vitin 2020.

#### **Tarifat e ofrimit të shërbimeve universale postare**

Tarifat për ofrimin e shërbimeve universale (bazë) postare brenda vendit, të ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. nuk kanë ndryshuar prej vitit 2002. Tarifat për shërbimet e ofruara brenda vendit për postën e letrave, variojnë nga 40 lekë për letrën e thjeshtë me peshë 20 gram, deri në 80 lekë për dërgimin e letrës me peshë 1001 deri në 2000 gram. Tarifat për objektet postare të porositura variojnë nga 70 lekë për letrën me peshë deri në 20 gr dhe 110 lekë për objektin e porositur me peshë deri në 2000 gram.

Po ashtu, çmimet e dërgimit të paketave të vogla, duke filluar nga 250 gram deri në 2 kg, variojnë nga 50 lekë në 200 lekë për dërgesat e thjeshta dhe 80 lekë deri në 230 lekë për ato të porositura. Ndërkohë, tarifat për dërgesat postare ndërkombëtare, ndryshojnë disa herë në varësi të peshës së tyre. Dërgimi i letrës me peshë 20 gram në Evropë është 130 lekë dhe ajo me peshë deri në 2000 gram 2400 lekë, ndërsa për dërgimin e letrës së porositur këto tarifa janë përkatësisht 310 lekë dhe 2580 lekë.

Në grafikun e mëposhtëm jepet një krahasim për tarifat e dërgesave të letrës së thjeshtë dhe asaj prioritare, mes disa vendeve të rajonit.



*Figura 7. Çmimet për dërgimin e një letrë të thjeshtë dhe prioritare.  
Burimi: Raporti ERGP dhe Posta Shqiptare sh.a.*

Politikat tarifore në tregun postar janë të ndryshme në vende të ndryshme të Evropës, por në dallim me vendin tonë, në Evropë ka pasur rritje të ndjeshme të tarifave, kryesisht për dërgesat e objekteve postare letër e thjeshtë ose prioritare.

Bazuar në raportin e ERGP-së (Grupi i Rregullatorëve Evropianë Postarë), çmimi mesatar në Evropë për dërgimin e një letrë prioritare me peshë deri 20 gr brenda vendit është 0.91 euro. Ky çmim ka pasur një rritje me 9.3% gjatë periudhës 2014–2018. Çmimi mesatar në Evropë për dërgimin e një letrë të thjeshtë me peshë deri 20 gram, brenda vendit, është 0.64 euro dhe ka pasur një rritje mesatare prej 1.8% në vitin 2018 kundrejt vitit 2017.

Në figurat e mëposhtme jepen ecuria e tarifave për shërbimin postar në vendet evropiane për letrën prioritare deri në 20 gram brenda vendit dhe brenda Evropës, si dhe ecuria për çmimin për dërgimin e pakove me peshë deri në 2 kg brenda vendit dhe brenda Evropës.




Figura 8: Ecuria e çmimeve për shërbimet postare në Evropë.

Burimi: ERGP PL II(19) 37 Report on postal core indicators dhe të dhënat e Posta Shqiptare sh.a.

Referuar tarifave të aplikuara në Shqipëri nga ofruesi i shërbimit universal, tarifat për dërgimin e letrës me peshë 20 gram brenda vendit janë përkatësisht 70 lekë për letrën e porositur dhe 40 lekë për letrën e thjeshtë.

Në një studim të kryer nga Banka Botërore<sup>3</sup> për tregtinë elektronike në Shqipëri, kur analizohet pjesa e shërbimeve postare thuhet që megjithëse Posta Shqiptare sh.a. ofron shërbime me kosto të ulët në të gjithë Shqipërinë, çmimet janë ende të larta në krahasim me të ardhurat lokale. Ky konstatim, mund të kërkojë një analizë më të detajuar, në lidhje me çmimet për dërgesat e pakove dhe në veçanti nëse kjo i referohet shërbimit universal postar.

Për sa i përket ecurisë së çmimeve për dërgimin e pakove, vërehet se në Evropë çmimet për dërgimin e pakove deri në 2 kg kanë pasur shumë pak ndryshime, si për dërgimin brenda vendit ashtu dhe ato në vende të tjera të Evropës.

Politikat tarifore janë të ndryshme në vende të ndryshme; ka vende që nuk kanë diferenca në çmimin e dërgimit të letrës prioritare me atë të thjeshtë, si në Serbi, po ashtu ka vende ku nuk kemi pasur ndryshim të çmimeve në katër–pesë vitet e fundit, si në Bullgari, Greqi, sikurse ka dhe vende si Rumania, Kroacia që kanë pasur ndryshim në çmimet e dërgimit të letrave të thjeshta ose prioritare në periudhën 2014–2018.

Kuadri i ri ligjor miratuar në vitin 2015, ka prezantuar parimet për vendosjen e tarifave për shërbimet postare në veçanti ato për shërbimin universal, si dhe një model të ri të vendosjes dhe rregullimit të tarifave.

Tarifat për shërbimin bazë postar kanë qenë miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 446, datë 26.9.2002, “Mbi miratimin e tarifave postare bazë”, si dhe me vendimin e Këshillit

<sup>3</sup> Albania: E-commerce Diagnostic Leveraging the digital trade opportunity.

të Ministrave nr. 595, datë 31.8.2006, “Për miratimin e tarifave të Postës Direkte, tarifat postare të shërbimit “Posta Direkte” për kufijtë e zonës së rezervuar”.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri në vitin 2015, rregullimi i mëparshëm ligjor që kërkonte miratimin e tarifave të shërbimit universal apo bazë postar, me vendim të Këshillit të Ministrave është zëvendësuar nga regjimi i ri. Zhvillimet që kanë ndodhur në tregun postar, nevoja për t’u adaptuar me kërkesat dhe sfidat e reja, kërkojnë rishikimin periodik, përshtatjen e tyre me gamën e re të shërbimeve që ofrohen, duke u bazuar dhe në praktika të mira apo *benchmark* të rajonit.

Në lidhje me tarifat për ofrimin e shërbimeve postare universale, konstatohet se struktura e tarifave të objekteve postare të Posta Shqiptare, ka diferencë me ato të vendeve të BE-së. Tarifa të ulëta për disa objekte postare dhe më të larta për disa të tjera, si dhe mosrishikimi i tarifave për një periudhë shumë të gjatë kohore nga viti 2002, krijojnë probleme për stimujt për ofrim efikas të shërbimit universal postar. Rishikimi periodik i tarifave për ofrimin e shërbimeve postare me qëllim rritjen e eficiencës së ofrimit të shërbimeve postare është i nevojshëm.

Posta Shqiptare sh.a. ka prezantuar kërkesën për rishikimin e tarifave postare për shërbimin universal postar, në veçanti lidhur me nevojën e mbulimit të kostove për ofrimin e shërbimit universal. Kuadri ligjor parashikon mbulimin e kostove neto të ofrimit të shërbimit universal postar.

## **II.2 Probleme të Shërbimit Universal Postar në Shqipëri**

Ligji 46/2015, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se shpërndarja dhe dorëzimi i objekteve postare duhet kryer në adresën e marrësit në banesën e tij, në ambientet e punës ose të biznesit, ose në kutinë postare, të vendosur në ambientet përkatëse. Nga ana e Postës Shqiptare, si dhe nga kontrollat e ushtruara nga AKEP-i, është evidentuar se:

a) për objektet postare kolipostë/pako, për shkak të pamundësisë tekniko/logjistike dhe të problemeve lidhur me sistemin e adresave, Posta Shqiptare nuk i dorëzon plotësisht objektet postare kolipostë në adresë të marrësit, por dorëzohen në zyrat postare përkatëse;

b) paketat e vogla postare, për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin ekspres ndërkombëtar apo brenda vendit, dorëzohen në adresën e marrësit;

c) Paketat e vogla postare për të cilat dërguesi ka zgjedhur shërbimin universal postar apo jo universal, dorëzohen pjesërisht në adresën e marrësit, dhe pjesërisht dorëzohen pranë zyrave postare përkatëse.

Për objektet postare, të cilat nuk dorëzohen në adresë, por pranë zyrave postare përkatëse, Posta Shqiptare kryen njoftimin për tërheqjen e objektit postar nëpërmjet dëftesës së shkruar mbi mbërritjen e objektit postar, por edhe duke përdorur mjetet elektronike si njoftimi me SMS. Pas njoftimit mbi tërheqjen e objektit postar, marrësi paraqitet në zyrën postare për tërheqjen e objektit postar.

Problemi lidhur me saktësinë e adresave në Shqipëri është një faktor përkeqësues i cilësisë së ofrimit të shërbimeve postare në tërësi dhe i shërbimit universal postar në veçanti. Ky problem rrit kostot e ofruesve të këtyre shërbimeve për shpërndarjen e pakove postare, si dhe ka impakt negativ në shërbime të tjera. Ky problem është evident dhe në sistemin gjyqësor i cili në disa raste ka paraqitur dhe ankesa në AKEP për mosdorëzim të njoftimeve palëve ndërgjyqëse, për shkak të problemit të adresave jo të sakta. Të gjitha këto në fund rezultojnë në kosto ekstra për qytetarët shqiptarë për shërbimet e përmendura. Kjo ndikon, gjithashtu, negativisht edhe në tregtinë *online*, pasi qytetarët që përdorin këto shërbime janë të detyruar të mbajnë radhë dhe shpenzojnë kohë në sportele për të marrë produktet e porositura.

## **III. Tendencat globale dhe evropiane – sfidat në zhvillimin e tregut postar**

Zhvillimet në tregun postar, tregojnë për një tendencë globale në reduktimin e volumit të postës së letrave dhe rritjen e shpejtë të dërgesave të pakove për shkak të tregtisë elektronike. Në kontrast me tregun e postës së letrave, tregu i postës së pakove ka një rritje të fortë, tendenca në rritje e së cilës vazhdon. Në Evropë ky treg, në tre–katër vitet e fundit, ka pasur mbi 13% rritje mesatare vjetore. Rritja e tregut të postës së pakove, rrit nevojën për përshtatjen e infrastrukturës përkatëse të rrjetit postar dhe të investimeve në këtë drejtim.

Këto zhvillime sjellin sfida si për operatorët postarë, në veçanti në ofrimin e shërbimit universal postar, por dhe për politikbërësin dhe organin rregullator. Nga ana tjetër, zhvillimet në sektorin postar ndikojnë në industrinë e tregtisë elektronike.

Në sektorin postar, digjitalizimi dhe *e-Zëvendësueshmëria* është një nga çështjet që diskutohet prej vitesh për impaktin që ka në tregun e postës së letrave, por njëkohësisht dhe për mundësitë që digjitalizimi ofron në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve postare.

Komunikimet elektronike janë të shtrira gjerësisht sot dhe numri i shërbimeve publike që ofrohen në rrugë elektronike është rritur ndjeshëm. Një pjesë e mirë e komunikimeve me institucionet publike, janë zëvendësuar me aplikime *online*, duke sjellë përfitime dhe lehtësira të padiskutueshme për publikun. E parë thjesht në këndvështrimin e sektorit postar, kjo mënyrë e re e marrjes së shërbimeve, çon në reduktimin e postës së letrave. Nga ana tjetër, është një mundësi përmes digjitalizimit. Aksesit për shërbimet elektronike është një mundësi e shtuar për marrjen e shërbimeve cilësore në zyrat e ofruesit të shërbimit universal, pasi në zyrat postare ofrohen shumë shërbime në të njëjtën pikë.

### ***Shërbimi postar dhe tregtia elektronike***

Gjatë viteve të fundit, tregtia elektronike, e përkufizuar si shitja e mallrave dhe e shërbimeve *online*, po krijon rrugë të reja për zhvillimin ekonomik. Për ofruesit e mallrave dhe të shërbimeve, tregtia *online* paraqet një mundësi unike rritjeje. Nëpërmjet shitjeve *online*, bizneset mund të arrijnë konsumatorë të cilët mund të mos ndodhen pranë fizikisht – si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm. Ofrimi i shërbimit të shitjeve *online* në 24 orë përbën një lehtësi për konsumatorët. Sipas analizës së kryer nga ekspertët e Bankës Botërore<sup>4</sup>, tregtia elektronike është një mundësi rritjeje për Shqipërinë. Tregtia elektronike çdo ditë po bëhet akoma më shumë pjesë e ekonomisë globale.

Penetrimi i *e-Commerce* në Shqipëri, është i limituar dhe mbetet pas fqinjëve të rajonit. Sipas anketës *Global Findex 2017*, vetëm 7% e shqiptarëve kanë raportuar se kanë përdorur internetin për të kryer blerje *online* gjatë vitit të fundit, në krahasim me 14% të pjesës tjetër të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Kjo është vlere më e ulët midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe është larg vendeve të tjera në rajon me të njëjtin nivel të ardhurash, si Moldavia. Megjithatë vërtetimi më i fundit, i kryer nga Instituti i Statistikave<sup>5</sup>, jep një rritje të bizneseve që kanë përdorur tregtinë elektronike në Shqipëri. Sipas këtij raporti në vitin 2020, nga 88,9% e ndërmarrjeve, faqja e internetit është përdorur për të shfaqur katalogët e produkteve ose çmimet e tyre kundrejt 87,8% që ishte në vitin 2019.

Në vitin 2020, 12,8% e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/shërbime nëpërmjet faqes së internetit, aplikacioneve të dedikuara, faqeve të internetit *e-Commerce* dhe aplikacioneve të përdorura nga ndërmarrje të ndryshme për tregti të produkteve. Peshën më të madhe të tregtisë elektronike e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitetet në fushën e akomodimit dhe aktivitetet të shërbimit të ushqimit me 38,2%, pasuar nga informacioni dhe komunikacioni me 30,1% dhe shërbime administrative dhe mbështetëse me 21,1%.

Sipas UNCTAD-it (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin) fushat e politikave për zhvillimin e tregtisë elektronike përfshijnë:

- infrastrukturën TIK dhe shërbimet elektronike;
- pagesat;
- shërbimet e logjistikës;
- kuadri ligjor e rregullator;
- zhvillimi i aftësive TIK;
- financimin për *e-Commerce*;
- vlerësimi i *e-Commerce*/statistikat.

Ofrimi i shërbimeve të logjistikës, për mundësimin e dërgimit të shpejtë dhe me kosto të ulët, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e treguesve të tregtisë elektronike. Rolin kryesor

<sup>4</sup> Albania: *E-commerce Diagnostic Leveraging the digital trade opportunity.*

<sup>5</sup> [http://www.instat.gov.al/media/8084/njoftimi\\_p%C3%ABr\\_shtyp\\_tik\\_2020.pdf](http://www.instat.gov.al/media/8084/njoftimi_p%C3%ABr_shtyp_tik_2020.pdf)

për dorëzimin e pakove postare te konsumatorët, e luan shërbimi postar. Një shpërndarje efiçiente në kufi e pakove ndërkufitare është shumë e rëndësishme për tregtinë elektronike. Në analizat e bëra vlerësohet që nevojitet që në shërbimin ndërkufitar të dërgesave të mëdha (kolive postare) dhe të vogla (pakot), të ketë përmirësime në lidhje me tarifën e shërbimeve ndërkufitare, thjeshtim të procedurave administrative, reduktim të kohës së përpunimit etj., në një situatë ku volumi i pakove postare vijon të rritet me ritme të shpejta.

Posta Shqiptare sh.a. ka një mbulim shumë të mirë të territorit të Shqipërisë, megjithatë ka ende hapësirë për të forcuar besueshmërinë dhe përmirësuar ofrimin e shërbimit. Posta Shqiptare sh.a. vazhdon të ofrojë një rrjet të qëndrueshëm të zyrave të saj, duke lidhur shqiptarët me njëri-tjetrin dhe me pjesën tjetër të botës. Bazuar në statistikat e UPU-sit, 96% e popullsisë e marrin postën të dorëzuar në shtëpi. Zonat rurale përfitojnë shërbim mesatarisht tri herë në javë. Sidoqoftë, cilësia e shërbimit ka vend për përmirësim. Sipas vlerësimit të besueshmërisë së kryer nga UPU-si, bazuar në kohën mesatare dhe ndryshueshmërinë e kohës së dorëzimit, Shqipëria renditet me ulët krahasuar me rajonin.

Në panoramë pak më e zgjeruar e zhvillimit të tregtisë elektronike në vendin tonë, gjatë viteve të fundit, gjendet në faqen e dedikuar për tregtinë elektronike: [etradeforall.org](http://etradeforall.org). Kjo faqe është një iniciativë me shumë aktorë, e angazhuar për ta bërë ekonominë digjitale më gjithëpërfshirëse. Informacioni për Shqipërinë gjendet në adresën: <https://etradeforall.org/wp-content/uploads/countryprofiles/2021/ALBANIA.pdf>

Sistemi i adresave në Shqipëri vijon të mbetet një pengesë për dërgesa postare në kohë dhe me kosto efektive. Duke pasur parasysh urbanizimin e shpejtë dhe ndryshimin e herëpashershëm të emrave të rrugëve, sistemi i adresave mbetet i rëndësishëm për përmirësimin e shërbimit të dorëzimit të dërgesave postare. Mungesa e një sistemi adresash të konsoliduar ndikon në rritje të kostove operative të dorëzimit dhe shkakton vonesa.

Ndërkohë, kostoja e shërbimit postar ndërkombëtar ndikohet nga mosbarazia midis dërgesave të pakove postare në hyrje dhe në dalje. Sipas UPU-sit, më shumë se trefishi i pakove postare hyjnë në Shqipëri, se sa dërgohen jashtë (kjo pasqyrohet edhe në bilancin e përgjithshëm tregtar të Shqipërisë), që do të thotë se aeroplanët dhe kamionët, të cilët udhëtojnë jashtë, shpesh nuk janë të ngarkuar me kapacitet të plotë, duke rritur në këtë mënyrë kostot e dorëzimit.

Cilësia e tregtisë dhe procedurat doganore janë thelbësore për të shfrytëzuar në maksimum përfitimet e tregtisë elektronike ndërkufitare. Përveç koston së drejtpërdrejtë të pagesës së taksave dhe detyrimeve në doganë, barra e procedurave administrative ndikon në koston, shpejtësinë dhe komoditetin e tregtisë ndërkufitare. Në rastin e tregtisë elektronike ndërkufitare dhe shpërndarjen e pakove postare të vogla, këto shqetësime janë rritur, shpesh për shkak të kostove të procedurave administrative, të cilat janë më të larta se vetë vlera e dërgesës.

Në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, Shqipëria ka një regjim të thjeshtuar për tregtinë ndërkufitare për dërgesat e vogla, aktualisht aplikohet një vlerë *de minimis* prej 22 eurosh, nën të cilën importet përjashtohen nga TVSH-ja e importit dhe detyrimet doganore, duke kursyer në kosto administrative. Tregtarët e autorizuar që përpunojnë një numër të madh pakosh postare ndërkufitare (të tilla si kompanitë e logjistikës që trajtojnë një numër të madh pakosh postare në emër të shitësve *online* ndërkufitarë), mund të plotësojnë deklarata të thjeshtuara për secilin objekt, të cilat ndiqen më pas nga plotësimi i një deklarate shtesë përmbledhëse brenda 24 orëve. Në fokusin e këtij dokumenti është zhvillimi dhe përmirësimi i shërbimeve postare, përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të logjistikës postare që ndihmojnë zhvillimin e mëtejshëm të tregtisë elektronike.

#### ***Ndikimi i COVID-19 në shërbimin postar***

Viti 2020 ishte një vit i vështirë për ekonominë botërore. Sektori postar dhe në veçanti ofrimi i shërbimit postar u prek rëndë për shkak të situatës së mbylljes dhe ndërprerjes së transportit ajror në shumë vende. Pjesa më e madhe e operatorëve postarë në botë, deklaruan Situatën e Emergjencës së Forcës Madhore dhe nuk merrnin përsipër garantimin e standardeve të cilësisë në shpërndarjen e objekteve postare.

Kjo situatë pati ndikim dhe në Shqipëri, pasi të gjitha linjat ajrore me të cilat operonte Posta Shqiptare sh.a. për dërgimin e postës jashtë vendit, si dhe ato hyrëse, ndërprejnë fluturimet nga dhe për aeroportin Nënë Tereza, si për pasagjerët, ashtu edhe për shërbimin cargo. Kjo bëri të pamundur vijimin normal të postës ndërkombëtare. Një situatë e ngjashme dhe vështirësi në ofrimin normal të shërbimit postar, pati për të gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Për zgjidhjen e situatës së krijuar Posta Shqiptare sh.a. shqyrtoi të gjitha mundësitë për vijimin e postës me partnerë të tjerë, në numrin më maksimal të mundshëm të destinacioneve për të gjetur zgjidhje. Në situatën e bllokimit të trafikut ajror transporti i dërgesave postare vijoi në rrugë tokësore, gjë që solli vonesa në shpërndarjen e objekteve postare. Shërbimi ekspres për jashtë është mbuluar pjesërisht nëpërmjet shërbimit EMS dhe plotësisht në të gjitha destinacionet nëpërmjet shërbimit SEM. Në këtë periudhë, shërbimi EMS u ofrua vetëm në 5 destinacionet e tij kryesore: SHBA, Kanada, Angli, Itali dhe Francë. Në fund të vitit 2020 ofrimi i shërbimeve postare ndërkombëtare nga Posta Shqiptare sh.a., mundësohej në rreth 90 destinacione ndërkombëtare.

Situata e pandemisë nxori si nevojë adaptimin e politikave dhe të modeleve të biznesit më të zhdërvjellta në sektorin postar, si dhe rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit për shfrytëzimin e infrastrukturës, mjeteve të transportit midis operatorëve/ofruesve kombëtare dhe rrjetit postar global.

Për të përballuar sa më mirë dhe në mënyrë efektive situata të tilla, si ajo e pandemisë apo situata të tjera të jashtëzakonshme, nevojitet hartimi i një plan veprimi për sigurimin e ofrimit të shërbimeve në këto raste. Sipas përcaktimeve të nenit 53, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, një plan i tillë hartohet nga ofruesi i shërbimit universal dhe i paraqitet ministrit përgjegjës dhe AKEP-it.

#### ***Sfidat e zhvillimit në tregun postar***

Në mënyrë të përmbledhur sfidat që shoqërojnë zhvillimet në tregun postar konsistojnë, në:

#### **Reduktimi i postës së letrave:**

Për operatorët postarë: do të thotë një ekonomi shkalle më e ulët, kosto e ofrimit të shërbimit për njësi/objekt postar më e lartë; ulje të të ardhurave, për pasojë ulje të investimeve; presion për të reduktuar rrjetin postar/reduktimin e pikave të aksesit; rritje të çmimeve, vështirësi në mbajtjen e numrit të punonjësve etj.

#### **Rritja e tregtisë elektronike dhe volumet e pakove postare:**

Për operatorët postarë: kemi rritje të presionit për të përshtatur rrjetin postar që i shërben shpërndarjes së pakove;

potencialisht ulje në të ardhurat nga posta e letrave hyrëse ndërkombëtare, për shkak të tarifave të fiksuara (*terminal dues* të vendosur nga UPU-si); konkurrencë më e lartë; presion për ulje të kostove dhe marrjen e masave për ndikimin në ambient, synimi për zhvillime në një ekonomi të gjelbër me nivel të ulët të dyoksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>), që kërkon reduktim të ndikimit në mjedis nga mjetet e transportit të rrjetit postar.

Të dyja këto zhvillime, sjellin, gjithashtu, sfida për institucionet politikëbërëse dhe rregullatore. Në veçanti tendenca e uljes së volumit të letrave postare përkthehet, në:

- kosto më e lartë për ofrimin e shërbimit postar, në rrezik potencial për rritje të çmimeve duke u shoqëruar me impakt social;

- vështirësi në ruajtjen e konkurrencës në tregun e letrave;

- rritje të kostos për ofrimin e shërbimeve në zonat rurale.

Rritja e volumit në tregun e pakove, çon, gjithashtu, në nevojën për një kuadër të ri rregullator/mënyrën e rregullimit për shërbimin universal postar, si dhe bën presion për ndryshim të ligjit postar në përcaktimet/përkufizimin e shërbimit universal postar dhe në kërkesat për cilësinë e shërbimit (QoS) etj.

Nga konsultimi me operatorët e tregut postar në vend, ngrihen disa shqetësime dhe problematika, në lidhje me zhvillimin e tregut postar, që ndërthurin probleme të konkurrencës së



ndershme, ndikimin e zhvillimit teknologjik, praktikat rregullatore, zhvillimin e infrastrukturës postare etj.

Liberalizimi i tregut pritet të sjellë ende ndryshime në strukturën e tregut. Sfida të tjera dalin nga nevoja për të balancuar interesat e veçanta, si për tregun e shërbimeve postare të mirëfillta, ashtu edhe për tregun e shërbimeve bankare financiare.

Gjithashtu, procesi i liberalizimit të tregut ka sjellë sfida të reja, të tilla si ngarkesa dhe konkurrenca në nivele maksimale. Nga kjo pikëpamje, nevojitet një kuadër rregullator për të garantuar që rregullat e tregut të mos shkelen nga asnjë aktor. Disa ofrues të shërbimit postar u ankuan për konkurrencë të pandershme nga subjekte të palicencuar në tregun postar. Kjo është një çështje që do vëmendje të vijueshme rregullatore, si për evidentimin dhe për marrjen e masave korigjuese.

Modelet e biznesit postar kanë ndryshuar, janë ndikuar më tej nga rritja e tregtisë elektronike, nga ekonomia e internetit dhe modelet e inovacionit të partneritetit, nga luhatshmëria e kostos së shërbimeve, si dhe nga evolimi i shërbimeve financiare, rritja e numrit të tyre dhe qasja në tregun e kapitaleve.

Në fushën e zhvillimit të tregtisë elektronike dhe rolin e sektorit postar është i nevojshëm adoptimi i praktikave të mira për pjesën e doganave, si aplikimi i *pre-clearance*. Për këtë është e nevojshme rritja e bashkëpunimit me doganat dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Përmirësimi, plotësimi i kuadrit rregullator, në lidhje me praktikat tarifore/pagesat ndërkufitare sipas praktikës së BE-së, që ndikon te zhvillimi i tregtisë elektronike është, gjithashtu, një nevojë.

Përdorimi i kodit postar duhet të bëhet i detyrueshëm për të gjitha dërgesat postare, po ashtu dhe saktësimi i sistemit të adresave si një nga problematikat e mëdha për sektorin postar.

#### **IV. Vizioni dhe objektivat e sektorit postar**

Ky dokument politikash përcakton këtë vizion për zhvillimin e sektorit postar në periudhën afatmesme, afatgjatë:

##### ***Ofrimi i shërbimeve postare me cilësi dhe besueshmëri të lartë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë bazuar në teknologjitë e reja dhe zgjidhjet inovatore.***

Sektori postar ka një mundësi të madhe zhvillimi si një pjesë e rëndësishme e ekonomisë kombëtare. Duke marrë parasysh ndryshimet e shpejta të teknologjisë, të ekonomisë dhe kërkesave të shoqërisë dhe duke u mbështetur në pikat e saj të forta, si rrjeti i shtrirë në të gjithë vendin me zyrat postare, ofrimi i shumë shërbimeve në një zyrë të vetme etj. misioni i sektorit postar mbetet i rëndësishëm në ditët e sotme. Zhvillimi i shpejtë i këtij sektori mbështet te reformat e ndryshimeve dhe implementimi i projekteve bashkëkohore.

Ky dokument përcakton si objektiva të zhvillimit të sektorit postar për periudhën 2021–2026:

- zhvillimin e infrastrukturës së rrjetit postar përmes përmirësimit/ngritjes së një qendre tranziti bashkëkohore;

- zbatimin e standardeve ndërkombëtare për rrjetin dhe shërbimet postare;

- garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të shërbimeve postare universale cilësore e të kudondodhura;

- integrimin e sa më shumë shërbimeve postare e financiare, krijimi i paketave të shërbimeve duke u gjendur sa më pranë konsumatorëve;

- garantimin e qarkullimit të lirë të objekteve postare, në një ambient të vetëm postar, të përbërë nga rrjete të ndërlidhura me njëri-tjetrin;

- inkurajimin e arritjes së standardeve të ndershme të përbashkëta për të gjithë operatorët e tregut;

- mbështetjen në implementimin e teknologjisë bashkëkohore të inovacionit;

- garantimin e cilësisë së shërbimit universal postar;

- zhvillimin e tregtisë elektronike brenda vendit dhe në rajon përmes rritjes së cilësisë së shërbimit dhe infrastrukturës mbështetëse;

- rritjen e kapaciteteve të sektorit postar përmes kualifikimit të stafit punonjës.

## **V. Masat që do të ndërmerren**

Mosha digjitale dhe ndryshimet në modelet e konsumit kanë kontribuar në evolucionin e konsumatorit të së nesërme. Teknologjia është çelësi për të kuptuar transformimin aktual dhe të ardhshëm. Rritja e pashembullt e tregtisë elektronike, ka çuar në një rritje të dukshme në vëllimet e pakove dhe në nevojën për rritjen e kapaciteteve të përpunimit dhe padysim të modernizimit të këtij sistemi. Në këtë drejtim është e nevojshme të mbështeten iniciativa që lejojnë sektorin postar të ripozicionohet dhe të konsiderohet si një komponent thelbësor i ekonomisë digjitale.

Ndryshimet e shpejta të nevojave të bizneseve dhe klientëve në mbarë vendin, i detyrojnë operatorët postarë dhe, në veçanti, Postën Shqiptare sh.a., të synojë integrimin e zgjidhjeve të reja përgjatë gjithë rrjetit kompleks dhe të gjerë postar.

Për arritjen e këtyre objektivave do të bashkëpunohet me AKEP-in, sektorin postar dhe institucionet përkatëse për çështjet që lidhen me tregun dhe doganat. Me qëllim arritjen e këtyre objektivave do të ndërmerren masat si më poshtë:

### **Përmirësimi i infrastrukturës postare:**

- do të mbështetet konsolidimi i rrjetit të zyrave postare për ofrimin e shërbimit universal duke siguruar mbulimin territorial dhe të popullsisë në të gjithë vendin;

- do të investohet në digjitalizimin e mëtejshëm të zyrave postare për të siguruar marrjen e informacionit në kohë reale nga çdo pikë e postës;

- do të investohet për rritjen dhe modernizimin e zinxhirit të furnizimit dhe transportit në sektorin postar;

- do të investohet në përmirësimin e infrastrukturës postare për dërgesat e pakove përmes shtrirjes së prezencës së “bankomateve postare”;

- do të bashkëpunohet me ofruesin e shërbimit universal, AKEP-i dhe strukturat e tjera të lidhura për hartimin e planit të masave, për vijimin e ofrimit të shërbimeve postare në raste të jashtëzakonshme, sikurse COVID-19;

- do të bashkëpunohet me strukturat përgjegjëse për të nxitur përfundimin e një sistemi të konsoliduar të adresave postare dhe përdorimin e tij gjerësisht në sektorin postar;

- do të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar për të lehtësuar përballimin e kërkesës në rritje të dërgesave të pakove postare dhe situata të emergjencës, sikurse ajo e krijuar nga pandemia.

### **Përmirësimi i shërbimeve:**

- do të mbështeten politikat e diversifikimit të shërbimit dhe ofrimit të shërbimeve postare dhe financiare në çdo zyrë postare, për të lehtësuar marrjen e shërbimeve nga qytetari;

- do të bëhen investime për sistemin e shërbimeve *e-Money*, që synon përdorimin e tij si një shërbim financiar, për atë grup personash që nuk zotërojnë një llogari bankare;

- do të mbështeten strategjitë e zhvillimit për një model biznesi bashkëkohor, për administrimin e duhur të burimeve financiare, teknike a njerëzore të Posta Shqiptare sh.a.;

- do të punohet me Posta Shqiptare sh.a. dhe aktorë të tjerë të sektorit postar për të parashikuar në kohë ndryshimet sipas nevojave të konsumatorëve;

- do të monitorohet në mënyrë periodike cilësia e shërbimit postar dhe shërbimit universal postar, duke ndërmarrë masat e duhura korrigjuese për zbatimin e standardeve të larta;

- do të mundësohet ofrimi me cilësi të postës direkte, pakove dhe shërbimeve të personalizuar digjitale, sipas praktikave më të mira evropiane.

### **Rishikimi i tarifave për shërbimin universal postar:**

Me qëllim reflektimin e ndryshimeve të ndodhura në tregun postar, si dhe dinamikën e zhvillimeve, ministria do të bashkëpunojë me AKEP-in dhe Postë Shqiptare sh.a., për rishikimin e tarifave të shërbimeve universale postare, sipas praktikave më të mira. Gjithashtu, do të ndërmerren hapat e nevojshëm për adresimin e mbulimit të kostove neto, për ofrimin e shërbimeve universale postare në rastet e justifikuara, sipas parashikimeve në ligj.

### **Tregu digjital:**

- përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimit do të punohet për rritjen e tregtisë elektronike dhe tregtisë ndërkombëtare;

- do të punohet për implementimin e teknologjive të reja dhe inovacionit, për të përmbushur nevojat e konsumatorëve dhe administratës;

- do të shikohet mundësia për rrjete të reja të komunikimit dhe të përmirësuara postare në të ardhmen, si dhe të sigurohet ndërveprimi sipas standardeve ndërkombëtare;

- do të punohet për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit për tregtinë elektronike, të hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

- do të punohet për zbatimin e angazhimeve të Planit për Tregun e Përbashkët Rajonal të miratuar në Samitin e Sofjes, në nëntor 2020, në lidhje me shërbimet postare.

Në veçanti gjatë periudhës 2021–2025 nga Posta Shqiptare sh.a. do të implementohen një numër projektesh, që synojnë përmirësimin e performancës së sektorit postar.

### **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Në planin e bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar Strategjia Globale Postare, e miratuar nga UPU-si për periudhën 2020–2024, përcakton objektivat e zhvillimit, të cilat orientohen në katër fusha kryesore të veprimit:

- **Së pari**, ndërmarrja e masave nga qeveritë për zhvillimin postar, duke reduktuar diferencat, përmes rritjes së investimeve dhe fokusimin e politikave, me qëllim promovimin e mënyrave të ndryshme, përmes të cilave të përdoret rrjeti postar për zhvillimin social-ekonomik të vendeve;

- **Së dyti**, rregullatorët duhet të harmonizojnë dhe të prezantojnë kuadrin rregullator sektorial. Me rritjen e inovacionit, diversifikimin dhe investimet në fushën postare, është koha që rregullatorët të hyjnë fuqishëm dhe të menaxhojnë ndryshimet që po formësohen në sektorin postar;

- **Së treti**, operatorët postarë duhet të kërkojnë të rrisin performancën e tyre, duke implementuar strategji të diversifikuara dhe të përmirësojnë operacionet. Tregu postar sot operon me më shumë operatorë, ofrues shërbimesh, ndaj është e nevojshme që këta të fundit të jenë më inovativë në ofrimin e shërbimeve postare;

- **Së katërti**, grupet e tjera të interesit nga sektori privat dhe institucionet publike, duhet të integrohen në këtë sektor përmes angazhimit me aktorët tradicionalë dhe anasjelltas. Kjo nënkupton hapjen e tregut, forcimin e partnerishipit dhe rritjen e rolit të UPU-sit.

Në harmoni me këto orientime të Bashkimit të Përbotshëm Postar dhe me angazhimet në kuadër të integritimit evropian do të punohet, për:

- përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor e rregullator në sektorin postar, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar;

- zbatimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove postare, bazuar në eksperiencën dhe rregulloren (BE) 2018/644;

- realizimin nga ana Posta Shqiptare sh.a. në projekte të realizuara në bashkëpunim me strukturat operacionale të UPU-sit.

- mbështetjen dhe promovimin e projekteve për ekonominë e gjelbër dhe dekarbonizimin në sektorin postar;

- zbatimin e aktiviteteve për zhvillimin e tregtisë elektronike në komponentët e lidhur me shërbimin postar dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

### **Procesi i integritimit evropian**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me AKEP-in dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si drejtuese e kapitullit 3 të integritimit, do të ndjekë në vijimësi përmbushjen e angazhimeve në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për shërbimet postare.

Gjatë vitit 2021, u punua për transpozimin e rregullores së BE-së 644/2018 për shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove postare, e cila u miratua me udhëzimin nr. 5, datë 25.6.2021, “Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare”.

Do të ndiqen rregullisht raportimet për progresraportin, zbatimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian, nënkomitetin e tregut të brendshëm dhe konkurrenca, në lidhje me shërbimet postare.

### **Projekte të bashkëpunimit rajonal dhe me UPU-sin**

Posta Shqiptare sh.a. ka bashkëpunuar me strukturat operacionale të UPU-sit për realizimin dhe vijueshmërinë e tre projekteve të rëndësishme, si “Shko gjelbër me një flotë të modernizuar dhe ekologjike”, “Pjesëmarrje në Sistemin Global të Monitorimit (GSM) të menaxhuar nga UPU-si, në ciklin e matjes së cilësisë së shërbimit universal postar për periudhën 2-vjeçare (2020–2021), në sistemin GSM LINK me panelistë të jashtëm” dhe “Pjesëmarrje në Sistemin Global të Monitorimit (GSM) të menaxhuar nga UPU-si, në ciklin e matjes së cilësisë së shërbimit universal postar për periudhën 2-vjeçare (2020–2021), në sistemin GSM WORLD me panelistë të monitoruar dhe menaxhuar nga Posta Shqiptare sh.a.”.

Strategjia Globale Postare e miratuar nga UPU-si në vitin 2021 përcakton vizionin 2030 për tregun global postar, si dhe parashikon një numër objektivash dhe angazhimesh që vendet anëtare duhet të ndërmarrin për përmirësimin, modernizimin dhe prezantimin e zgjidhjeve inovatore për sektorin postar, të cilat jepen në aneksin 2.

Në përmbushje të këtyre objektivave, synimi është që në vitet e ardhshme bashkëpunimi me UPU-sin të jetë më i ngushtë dhe më gjithëpërfshirës.

Gjithashtu, ndër çështjet të cilat kërkojnë një vëmendje më të madhe dhe një bashkëpunim sa më frytdhënës, mund të veçohen bashkëpunimi me administratën doganore, përfshirja financiare dhe përgjigja ndaj fatkeqësive natyrore në rastin e forcës madhore.

*Bashkëpunimi me administratën doganore:* Rritja e tregut *online* ka sjellë një rritje të shkëmbimit ndërkufitar të kolipostave dhe pakove të vogla, duke ndikuar kështu në nevojën e një bashkëpunimi më të ngushtë midis operatorëve postarë dhe doganave, për rritjen e sigurisë. Për këtë, UPU-si punon me partnerë në zinxhirin e furnizimit për të vijuar me shkëmbimin ndërkufitar të këtyre mallrave postare. Sistemi i Deklarimit Doganor (CDS), i krijuar nga Qendra Teknologjike Postare e UPU-sit, ndihmon në zhdoganim, duke lejuar që Postat dhe Doganat pjesëmarrëse të shkëmbejnë të dhëna paraprake dhe të llogarisin detyrimet dhe taksat e nevojshme.

Për pakot e dërguara, kërkohet që operatorët postarë të ndajnë informacionin, në lidhje me dërguesin, përmbajtjen dhe vlerën me autoritetet doganore. Ky informacion më parë dërgohej me anë të një formulari, por CDS-ja tani u mundëson operatorëve që ta ndajnë këtë informacion përmes mesazheve elektronike të shkëmbimit të të dhënave (EDI), përpara dërgimit të pakove. Ky informacion paraprak ndihmon doganat të zvogëlojnë kohën e vet të përpunimit.

*Përfshirja financiare:* Parashikon ofrimin e shërbimeve financiare bazë (kursime, pagesa, transfertat parash, siguracione, kredi), për persona që nuk kanë akses në shërbime të tilla. Në të gjithë botën, këto shërbime financiare të ofruara nga operatorët postarë, përdoren nga 1.5 miliardë persona, duke e bërë sektorin postar kontribuesin e dytë më të madh në përfshirjen financiare mbarëbotërore. UPU-si ndihmon vendet e saj anëtare të prezantojnë ose zhvillojnë shërbime financiare gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Si një platformë informacioni dhe asistence teknike për sektorin postar, UPU-si është një partner ideal për institucionet huadhënëse dhe donatorët, në përpjekjen për t'i bërë shërbimet financiare postare të arritshme për popullsitë më të pafavorizuara.

*Përgjigja ndaj fatkeqësive natyrore në rastin e Forcës Madhore:* Vitet e fundit, bota është përballur shpesh me katastrofa natyrore dhe me situata emergjente, si në rastin e pandemisë globale të COVID-19 gjatë vitit 2020. Këto situata kanë pasur ndikim dhe në infrastrukturën e komunikimit të vendeve, përfshirë rrjetet postare. Fatkeqësitë natyrore dhe shëndetësore ndikojnë drejtpërdrejt në shërbimet postare publike, duke shkaktuar dëme në infrastrukturë, automjete dhe pajisje apo dhe ndërprerje të vetë shërbimit postar në mbarë botën, duke penguar një kanal të rëndësishëm tregtar dhe komunikimi. Në të njëjtën kohë, këto situata nxjerrin në pah vlerën e shërbimeve postare në përgjigjen paskatastrofës. Duke pasur parasysh rrjetin e tyre të gjerë, zyrat postare dhe qendrat e përpunimit të postës mund të veprojnë si pika të shpërndarjes për furnizimet e urgjencës, shërbimet postare mund të ndihmojnë në koordinimin e operacioneve të ndihmës emergjente. Ndër shërbimet më të rëndësishme, të cilat japin ndihmesën e tyre në situatat e fatkeqësive natyrore në rastin e forcës madhore theksojmë

Shërbimin e Postës Ekspres (EMS), që është një shërbim që ofrohet në rreth 200 vende në tërë botën, duke ofruar një dërgesë të shpejtë të objekteve postare.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal do të vijojë bashkëpunimi me organizatën evropiane për postë telekomunikacionin dhe ndiqen aktivitetet e CERP-së, si dhe do të ndiqen zhvillimet dhe takimet e Grupit Evropian të Rregullatoreve Postarë (ERGP) nga AKEP-i.

#### **VI. Monitorimi dhe zbatim i politikës postare**

Në zbatim të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, ministri përgjegjës për sektorin postar ngarkohet për hartimin dhe për zbatimin e politikave të zhvillimit të sektorit postar. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ngarkohet me rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve postare të ofruara në Republikën e Shqipërisë.

Nga pikëpamja operationale, drejtorja e politikave dhe strategjive të zhvillimit të telekomunikacionit dhe postave, në bashkëpunim me AKEP-in, do të ndjekë procesin e vazhdueshëm të implementimit dhe arritjes së objektivave të këtij dokumenti.

Për monitorimin e ofrimit të shërbimeve universale postare, do të shërbejnë indikatorët e performancës, sipas standardeve në ofrimin e shërbimit universal postar, që mbikëqyret nga AKEP, si:

- treguesi për kohën e shpërndarjes së letrës së thjeshtë ndërmjet qyteteve për D+1, D+2 dhe mbi D+2;
- treguesi për shpërndarjen e letrës rekomande midis qyteteve për D+1, D+2 dhe mbi D+2 etj.;
- treguesi për kohën e shpërndarjes së letrës së thjeshtë midis fshatrave për D+2, D+3 dhe D+4;
- treguesi për kohën e shpërndarjes rekomande midis fshatrave për D+2, D+3 dhe D+4.

Dokumenti i politikave postare do të rishikohet periodikisht, në varësi të zhvillimeve teknologjike dhe angazhimeve ndërkombëtare.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në procesin e përmbushjes së angazhimeve rajonale për tregun e përbashkët rajonal, si dhe planin e veprimit për zhvillimin e tregtisë elektronike.

Secili institucion përgjegjës për aktivitetet e parashikuara duhet të planifikojë realizimin e tyre duke garantuar buxhetet e duke planifikuar, burimet njerëzore dhe kapacitetet teknike, me qëllim realizimin e tyre.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të jetë përgjegjëse për hartimin e akteve ligjore, nënligjore të parashikuara në zbatim të këtij dokumenti.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare do të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve rregullatore për mbikëqyrjen e aktivitetit të ofrimit të shërbimeve postare dhe në veçanti të shërbimit universal postar.

Ofruesi i shërbimeve universale postare, Posta Shqiptare sh.a. do të jetë përgjegjëse për realizimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve postare universale.

Çdo vit do të bëhet vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve dhe i arritjes së objektivave të identifikuar nëpërmjet realizimit të indikatorëve.

#### **ANEKS 1**

#### **AKTET NËNLIGJORE TË MIRATUARA PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE**

Në zbatim të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, gjatë periudhës 2016–2018 janë miratuar edhe aktet nënligjore, si më poshtë:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 11.5.2016, “Për miratimin e rregullave për themelimin e fondit universal të shërbimit postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit në rast të bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimeve postare universale”. Vendimi siguron rregulla për fondin e shërbimit universal për kompensimin e kostos neto të shërbimeve postare universale në përputhje me dispozitat e *acquis* të BE-së;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 239, datë 2.5.2018, “Për miratimin e rregullave për caktimin e ofruesit të Shërbimit Universal Postar”. Vendimi siguron rregullat për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar me konkurrim publik, si dhe caktimin e zonës minimale për ofrimin e shërbimit universal postar;

- Rregullorja AKEP nr. 41, datë 3.3.2016, “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos së shërbimit postar universal”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP-it nr. 2670, datë 3.3.2016;

- Rregullorja AKEP nr. 42, datë 3.3.2016, “Për llogaritjen e kostove neto të shërbimit postar universal”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP-it nr. 2671, datë 3.3.2016;

- Rregullorja AKEP nr. 45, datë 27.10.2016, “Metodologjia e inspektimit të ofruesve të shërbimeve postare”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP-it nr. 2694, datë 27.10.2016;

- Rregullorja AKEP nr. 40, datë 17.12.2015, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare;

- Rregullorja AKEP nr. 39, datë 17.12.2015, “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”;

- Rregullorja AKEP nr. 20, datë 28.12.2015, “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”;

- Rregullorja AKEP nr. 38, datë 19.11.2015, “Për autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”;

- Rregullorja nr. 3, datë 29.10.2015, “Për ofrimin e shërbimit universal”;

- Udhëzimi i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5, datë 25.6.2021, “Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare”.

## ANEKSI 2

### NGA STRATEGJIA GLOBALE POSTARE E MIRATUAR NGA UPU-si – VIZIONI 2030

Nr.	
1.	<b><i>Qeveritë duhet të zvogëlojnë bosllëqet në zhvillimin e sektorit postar përmes rritjes së investimeve dhe politikave të fokusuara, dhe të promovojnë mënyra të ndryshme për të shfrytëzuar rrjetin postar për zhvillimin socio-ekonomik</i></b>
1.1	- Hartimi dhe miratimi i një politike kombëtare për sektorin postar, me role dhe objektiva të qartë për secilin nga aktorët e sektorit (ministra, rregullatori, operatorët dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut dhe autoritetet qeveritare).
1.2	- Matja e investimeve vjetore nga qeveria për aktivitete të lidhura me detyrimin e shërbimit universal në sektorin postar, në mënyrë që të sigurohet mbulim i plotë i kostos.
1.3	- Ofrimi i të paktën 10 shërbimeve qeveritare/qytetare, përmes sektorit postar. Këto mund të përfshijnë shërbime që lidhen me përfshirjen financiare, menaxhimin e fatkeqësive, shërbimet për të moshuarit, pagesat e pensioneve, mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), bujqësinë, trashëgiminë kulturore, teknologjinë etj.
1.4	- Hartimi i një plani postar kombëtar urgjent, si pjesë e strategjive kombëtare dhe lokale për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.
1.5	- Zvogëlim i hendekut të zhvillimit postar brenda rajoneve me 10% (të matura përmes indekseve të llogaritura nga UPU-si).
1.6	Përfshirja e sektorit postar në strategjinë kombëtare të çdo vendi për përmbushjen e OZHQ-ve.
2.	<b><i>Rregullatorët duhet të harmonizojnë dhe të përmirësojnë kuadrin rregullator të sektorit</i></b>
2.1	- Analizimi i statusit aktual të sistemit rregullator kombëtar në dritën e ndryshimeve teknologjike dhe të tregut dhe në krahasim me modelet e përdorura në industrinë e tjera (p.sh. telekomunikacioni).
2.2	- Zhvillimi i politikave kombëtare për të harmonizuar sistemin rregullator për sektorin postar, duke i harmonizuar ato me standardet ndërkombëtare të zhvilluara nga UPU-si
2.3	- Hartimi dhe miratimi i një kuadri rregullator kombëtar gjithëpërfshirës për të gjithë pjesëmarrësit e tregut që veprojnë në sektorin postar, jo vetëm operatorin tradicional.

2.4	- Krijimi i “hartave” rregullatore në të cilat të jenë të detajuara të gjithë aktorët në treg, pjesa e tyre e tregut dhe kuadri rregullator i zbatueshëm për secilin prej tyre
2.5	- Zhvillimi dhe zbatimi i një procesi monitorimi, vlerësimi dhe përditësimi kombëtar i rregulloreve për sektorin postar në baza 2–3-vjeçare.
2.6	- Analizimi i të gjitha aktiviteteve të mbuluara nga operatorët postarë dhe përcaktimi i rregullores së aplikueshme dhe autoritetit rregullator (p.sh. rregullorja për shërbimet e pagesave postare nën përgjegjësinë e një agjencie të përcaktuar qartë ose një grupi agjencish).
2.7	- Përditësimi dhe ripërcaktimi i sistemeve kombëtare të licencimit edhe për ofruesit e shërbimit universal, për të përmbushur objektivat e zhvillimit socioekonomik dhe për t’iu përshtatur ndryshimeve teknologjike dhe nevojave të tregut dhe qytetarëve.
2.8	- Analizimi i sistemeve të rregullave aktuale, kostove dhe licencimit të ofruesit të shërbimit universal dhe adaptimi i një modeli të përditësuar për ta financuar atë (p.sh. fondi i shërbimit universal, pagesa nga të gjithë operatorët, pagesa nga zyrat ekstraterritoriale të shkëmbimit (ETOE) etj.).
2.9	- Ngritja e kanaleve zyrtare të komunikimit midis autoritetit rregullator dhe sipërmarrjeve të ndryshme që operojnë në sektorin postar (siç janë takimet e rregulla në të cilat autoritetet takojnë përfaqësuesit e të gjithë aktorëve të tregut për të diskutuar mbi çështje të lëna pezull).
<b>3.</b>	<b><i>Operatorët duhet të synojnë të rrisin performancën e tyre duke vënë në zbatim strategji të ndryshme dhe përmirësime operationale</i></b>
3.1	- Dërgimi i postës në shtëpi për 90% të të gjithë familjeve në vendet në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara.
3.2	- Qasje në shërbimet postare për 100% të popullsisë.
3.3	- Operatorët e sektorit postar duhet të jenë në përputhje me përkufizimet dhe politikat kombëtare për shërbimin universal, si dhe me objektivat qeveritare për zhvillimin socioekonomik.
3.4	- Zhvillimi i mënyrave për llogaritjen me saktësi të kostos së ofrimit të shërbimit universal nga ana e të gjithë operatorët.
3.5	- Zhvillimi i një fushate kombëtare nga operatorët që ofrojnë shërbime qeveritare dhe/ose shërbime që bien brenda qëllimit të shërbimit universal për të promovuar kontributin e tyre në përmbushjen e OZHQ-së dhe rolin e tyre socioekonomik.
3.6	- Rishikimi i performancës së çdo vendi, në lidhje me zhvillimin postar, në mënyrë që të përcaktohen objektiva të saktë për përmirësim.
3.7	- Pajisja e të gjithë operatorëve me mjetet e nevojshme, me qëllim ofrimin e shërbimeve të dërgesave ndërkombëtare.
3.8	- Krijimi i një kanali/aktiviteti specifik për ofrimin e shërbimeve për NVM-të (p.sh. eksportet, trajnimet për tregtimin elektronik etj.) nga të gjithë operatorët.
3.9	- Reduktim i kohës së dorëzimit në të paktën ekuivalentin e mesatares rajonale për vitin 2020 për të gjitha llojet e postës (letra, pako dhe ekspres) nga të gjithë operatorët.
3.10	- Rritje e numrit të partnerëve të rrjetit ndërkombëtar për të arritur të paktën mesataren rajonale të vitit 2020 (të matur nga platformat e të dhënave të mëdha) nga të gjithë operatorët.
3.11	- Rritje e numrit të artikujve postarë të shkëmbyer me partnerët ndërkombëtarë, për të arritur të paktën mesataren rajonale të vitit 2020 (të matur me tonazhin e postës së eksportuar) nga të gjithë operatorët.
3.12	Trajnim i aftësive që lidhen me transformimin digjital nga i gjithë stafi postar i interesuar.
3.13	- Njohje dhe mbështetje nga ana e të gjithë operatorëve e objektivave të Marrëveshjes së Parisit për kufizimin e rritjes së temperaturës mesatare globale në më pak se 2°C mbi nivelet paraindustriale dhe përpjekje për ta kufizuar atë në 1.5°C mbi nivelet paraindustriale, përfshirë zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë.
<b>4.</b>	<b><i>Palët e tjera të interesit nga sektori privat dhe institucionet publike duhet të synojnë integrimin në sektor, duke u angazhuar me aktorët tradicionalë dhe anasjelltas. Kjo nënkupton hapjen e tregut, nxitjen e partneriteteve dhe rritjen e rolit të UPU-sit</i></b>
4.1	- Krijimi në çdo rajon të UPU-sit i qendrave për të lehtësuar shkëmbimin e artikujve postarë midis vendeve, duke integruar të gjithë aktorët e zinxhirit të furnizimit, si privat ashtu edhe publik.
4.2	- Zvogëlim i kohës së dorëzimit (shpejtësia dhe parashikueshmëria) nga çdo vend në shkëmbimet ndërkombëtare të artikujve postarë midis aktorëve të ndryshëm të zinxhirit të furnizimit, përfshirë operatorët, Doganat, linjat ajrore dhe rrugët/hekurudhat.
4.3	- Zhvillimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor nga çdo vend për krijimin e partneriteteve publike-private ndërmjet aktorëve të zinxhirit të furnizimit postar, përfshirë operatorët, doganat, linjat ajrore, <i>start-up</i> dhe kompanitë e tjera.
4.4	- Riorganizim i UPU-sit (në një mënyrë ende për t’u vendosur), në mënyrë që kategori të caktuara të aktorëve të tregut të jenë pjesëmarrëse në zgjidhjet operationale të UPU-sit (aty ku vendet anëtare e konsiderojnë të përshtatshme).
4.5	- Vendosja e marrëdhënieve zyrtare (ose zgjerim dhe përforcim i mëtejshëm i atyre ekzistuese) nga ana e UPU-sit me të gjitha organizatat që kontribuojnë në elementet e Vizionit Postar 2030 (p.sh. agjencitë e OKB-së dhe sindikatat e kufizuara).

